



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT
DEPARTAMENTI METODOLOGJISË, STANDARTEVE DHE SIGURIMIT TË CILËSISË

Nr. 724 Prot.

Tiranë, më 29.07.2020

Miratoi

KRYETARI

Arben SHEHU

PROGRAM TRAJNIMI (ON LINE)

Mbi

“Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH”
Për periudhën 15 Korrik - 30 Gusht 2020

- Mbështetur në Standardin Ndërkombëtar të INTOSAI-t mbi Auditimin e Jashtëm të Sektorit Publik (ISSAI 100), Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit Administrativ të KLSH, në zbatim të Programit të Zhvillimit Profesional të KLSH për vitin 2020, (miratuar me Vendim nr.187, datë 31.12. 2019 të Kryetarit të KLSH), të gjithë audituesit e Kontrollin e Lartë të Shtetit, sipas kalendarit të mëposhtëm, do të ndjekin Programin e Trajnimit “Mbi Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH dhe Dokumentet Standarde të Dosjes së Auditimit”.

- **Objekti i trajnimit:** Rregullorja e Procedurave të Auditimit në KLSH, miratuar me Vendim nr.107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH, i ndryshuar me Vendimin nr. 63, datë 22.06.2020. Ky dokument është publikuar në faqen web të KLSH-së, nga ku mund të aksesohet nga të gjithë ndjekësit e këtij trajnimi.
- Ky trajnim është konceptuar të realizohet online nëpërmjet platformës “Microsoft Skype”, për realizimin e komunikimit online me audio dhe video, bazuar në përcaktimet e Udhëzimit të Drejtorisë së IT me nr.2, datë 04.05.2020 “Mbi përdorimin e mjeteve teknologjike për zhvillimin e komunikimit online përgjatë periudhës së pandemisë”, me pjesëmarrjen në këtë platformë të audituesve të dy departamenteve gjatë një jave.
- Trajnimi individual, sipas Departamenteve do të kryhet nga e hëna në të premte, si dhe për çdo ditë, në orën e përcaktuar në program, do të realizohet diskutimi online i çështjeve të studiuara me trajnerin përgjegjës.
Për shkak të lejes vjetore të punonjësve, audituesit mund të ndjekin seancat e trajnimit me departamentet e tjera, duke bërë me dijeni Drejtorinë e Metodologjisë dhe Zhvillimit Profesional.
- Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit Profesional në bashkëpunim me Drejtorinë e IT, ndjek dhe monitoron zbatimin e Programit si dhe raporton mbi ecurinë në përfundim të procesit.

PROGRAMI

| DATE | TEMA E TRAJNIMIT | PËRSHKRIMI I TRAJNIMIT | TRAJNERË | ORARI I KOMUNIKIMIT ONLINE |
|-------------|--|--|-----------------|--|
| Dita e Parë | Planifikimi i Auditimit -Procedurat; -Dokumentimi | Njohja me hapat e fazës së Planifikimit të Auditimit Kryerja e takimit fillestar (Dokumenti 2) - Njohja me subjektin - Mbledhja e të dhënave - Hartimi i Memo-s mbi planifikimin e auditimit (D3) - Hartimi i Programit të Auditimit (D4) | Brunilda Zeneli | Nga ora 14. ⁰⁰ -15. ⁰⁰ |

| | | | | |
|---------------|--|---|-----------------|--|
| Dita e Dytë | Auditimi në terren -Procedurat -Dokumentimi | Njohja me hapat e fazës së terrenit - Prezantimi i Programit të Auditimit (Dokumenti 2/1) - Ndarja e detyrave, sipas njohurive dhe kompetencës profesionale (D5); - Deklarimi i konfliktit të interesit (D6); - Hartimi i letrave të punës (D7), me qëllim dokumentimin e riskut, nivelit të sigurisë, përcaktimin e testeve të kontrollit dhe testeve analitike, materialitetit, kufirit të materialitetit (sasior/cilësor), popullata, kampionimi, etj. Dokumentimi i punës audituese në Letrat e punës gjatë auditimit në terren. -Hartimi i Akt konstatimeve (D8) dhe Akt-Verifikimeve (Dokumenti 9) - Mbajtja e Takimit përmbyllës në terren (Dokumenti 2/2) | Brunilda Zeneli | Nga ora 14. ⁰⁰ -15. ⁰⁰ |
| Dita e Tretë | Raportimi -Procedurat -Dokumentimi | Njohja me hapat e fazës së Raportimit të auditimit -Përgatitja e informacionit Përmbledhës mbi PRA (D10) -Përgatitja e Shkresës përcjellëse të PRA (D11) Përgatitja e Projektraportit të Auditimit, pas shqyrtimit të vërejtjeve të subjektit; - Takimi ballafaques ne KLSH (D13) - Hartimi i Raportit Përfundimtar të Auditimit (D14) -Hartimi i projektvendimit (D15) - Sigurimi i cilësisë (D16.1/2/3/4) -Vendimi i Kryetarit të KLSH-së (D15/1) -Shkresa përcjellëse e RPA (D 17) Evidencat (D18, 19, 20, 21 dhe 22 Inventari) | Brunilda Zeneli | Nga ora 14. ⁰⁰ -15. ⁰⁰ |
| Dita e Katërt | - Njohja me llojet e auditimit dhe opinionet e auditimit, kryesisht të auditimit të përputhshmërisë dhe auditimit financiar. - Njohja me formën dhe përmbajtjen e tyre. | Llojet e auditimeve, kuptimi i tyre, referuar Standardeve të INTOSAI-IFPP 2019; -Llojet dhe dhënia e opinionëve mbi përputhshmërinë, referuar ISSAI 400, 4000 dhe Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë; -Llojet dhe dhënia e opinionëve mbi auditimin e Pasqyrave financiare, referuar ISSAI 200, 2000 dhe ISA/IFAC, “Standartet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur”; -Dhënia e opinionëve në rastet e Auditimeve të kombinuara, etj. | Brunilda Zeneli | Nga ora 14. ⁰⁰ -15. ⁰⁰ |

| | | | | |
|------------|-------------|--|-----------------|--|
| Dita Pestë | Përmbledhje | Diskutim interaktiv mbi të gjithë problematikat e evidentuara gjatë trajnimit, online. | Brunilda Zeneli | Nga ora 13. ⁰⁰ -15. ⁰⁰ |
|------------|-------------|--|-----------------|--|

KALENDARI I TRAJNIMIT PROFESIONAL

| Periudha e trajnimit | Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore | Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore | Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja | Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit | Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit | Departamenti i Auditimit të Performancës; Auditimi IT dhe Auditimi i Inovacionit dhe Sistemeve |
|----------------------|---|---|--|--|---|--|
| 27 Korrik-31 Korrik | | | | | | |
| 03 Gusht-07 Gusht | | | | | | |
| 10 Gusht-14 Gusht | | | | | | |
| 17 Gusht-21 Gusht | | | | | | |

DREJTORIA E METODOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT